



Bursa Tajvaneze

- Studime Tajvaneze
- Studime në marrëdhëniet ndërmjet Kinës dhe Tajvanit
- Studime të Republikës Popullore të Kinës
- Studime Aziatiko-Paqësore
- Aspekte tjera të Kinologjisë

Bursat Tajvaneze janë krijuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Tajvanit me qëllim të inkurajimit të ekspertëve dhe dijetarëve të huaj në të gjithë botën që të kryejnë hulumtime në universitetet apo institutet hulumtuese të Tajvanit, në mënyrë që të promovojnë partneritet dhe bashkëpunim të dyanshëm.

KUSHTET:

1. Përfituesit e bursës duhet të jenë profesorë të rregullt, profesor të asociuar, asistent profesor, hulumtues post-doktorature, kandidat doktorature ose student i doktoraturës në programe të njëjta me ato të universiteteve të huaja ose nese janë hulumtues të një niveli ekuivalent në institucione akademike jashtë shtetit.
2. Fushat e hulumtimit janë: Temat në shkencë shoqërore dhe shkencë humanistike që kanë të bëjnë me Republikën e Kinës (Tajvanin), Marrëdhëniet ndërmjet Kinës dhe Tajvanit, Republikën Popullore të Kinës, Studime Aziatiko-Paqësore dhe Kinologji.

PËRFITIMET:

1. Një biletë kthyesë të klasës ekonomike me fluturimin më direkt për në Tajvan (subvencioni vendoset nga Ministria e Punëve të Jashtme në pajtim me rregullat e tyre)
2. Bursa mujore:
 - a. Profesorët e rregullt, Profesorët e asociuar, hulumtuesit ose hulumtuesit e asociuar me nga : 60.000 NTD (përafërsisht 1,700 euro)
 - b. Asistent profesorët, asistent hulumtuesit apo kandidatët e doktoraturës : 50.000 NTD (përafërsisht 1,430 euro)
3. Kohëzgjatja minimale e bursës është tre muaj ndërsa kohëzgjatja maksimale një vit.
4. Sigurimi i aksidentit personal (plus një sigurim mjekësor në rast të lëndimeve aksidentore) që mbulon vlerën deri në 1 milion NTD (Dollarë Tajvanez).

KOHA PËR APLIKIM ËSHTË PREJ 1 MAJ DERI MË 30 QERSHOR

Aplikoni online në: <http://taiwanfellowship.ncl.edu.tw/eng/apply01.aspx>



1088 Budapest, Rákóczi út 1-3., Hungary | Tel +36 1 266 2884 | Fax + 36 1 266 4003 | www.taiwanembassy.org/HU